LIGJ
Nr. 38/2018

PËR RATIFIKIMIN E KORRIGJIMIT TË MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR HUAN E POLITIKËS SË ZHVILLIMIT TË SEKTORIT FINANCIAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet korrigjimi i marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.7.2018

Shpallur me dekretin nr. 10842, datë 26.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

BANKA BOTËRORE
BNRZH - IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE

Lindda Van Gelder
Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe i Azisë Qendrore

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

23 janar 2018

Shkëlqesisë së Tij, z. Arben Ahmetaj
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë
Shqipëri

I nderuar z. ministër,

Huaja e politikës së zhvillimit të sektorit financiar (huaja nr. 8698-Al)
Korrigjim në Marrëveshjen e Huas

Ne i referohemi Marrëveshjes së Huas për projektin e përmendur më lart, të datës 20 mars 2017, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Bankës).

Qëllimi i këtij korrigjimi është korrigjimi i dy datave të fundit të shlyerjes dhe i kësteve përkatëse (të shprehura si përqindje). Si rrjedhojë, data "15 shtator 2048" është rishikuar dhe lexohet "15 mars 2048, me këst (të shprehur në përqindje) prej 2.08%" dhe vendoset një datë e re dhe përfundimtare shlyerjeje, konkretisht "15 shtator 2048, me këst (të shprehur në përqindje) prej 2.24%", siç parashtrohet në tabelë, në skedulin 2 të Marrëveshjes së Huas për veprimin e referuar më lart.

Ju lutem, gjeni bashkëlidhur tabelën e korrigjuar në skedulin 2 të Marrëveshjes së Huas.

Ky korrigjim hyn në fuqi në datën e kësaj letre. Do ta vlerësonim shumë nëse do të mund të na dërgoni sa më herët që të jetë e mundur konfirmimin e marrjes së kësaj letre.

Me respekt
(nënshkrimi)

Linda Van Gelder
Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe i Azisë Qendrore
Tel.: +43 (1) 2170 782
Fax: +43 (1) 2170 701

Shkëlqesisë së Tij, Arben Ahmetaj

23 janar 2018

SKEDULI 2

Data e pagesës së principalit	**Kësti (i shprehur si përqindje)**
Në çdo datë 15 mars dhe 15 shtator Duke filluar nga data 15 mars	2.08%

2025 deri më 15 mars 2048	
Më 15 shtator 2048	2.24%

Tel.: +43 (1) 2170 782; fax: +43 (1) 2170 701